



Npi – 01/288 Datë: 30.08.2024

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) nenin 17 shkronja (o) dhe nenin 40 shkronja (i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Nenin 7 dhe 8 të Ligjit për Sistemin e Adresave Nr.04/L-071 i datës 08.12.2011; Nenin 54.8 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Si dhe duke marrë parasysh propozimin e Kryetarit të Komunës së Shtimes, Nr.02/897 të datës 22.08.2024, dhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa me numër Npi-01/281 të datës 28.08.2024, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.08.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR ZGJEDHJEN KOMISIONIT PËR EMËRTIMIN E RRUGËVE DHE SHESHEVE NË KOMUNËN E SHTIMES

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VIII- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më datën: 30.08.2024, unanimisht, miratoi Vendimin për formimin e Komisionit për vlerësimin e kërkesave lidhur me emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Shtimes, në këtë përbërje:

1. Zejnije Veliu.....përfaqësues nga pozita,
2. Kadri Emini.....përfaqësues nga pozita,
3. Lulzim Sahiti.....përfaqësuese nga ekzekutivi,
4. Sami Januzi.....përfaqësuese nga ekzekutivi,
5. Abdyl Hajredini.....përfaqësues nga komuniteti intelektual,
6. Naim Zeqiri.....përfaqësues nga komuniteti intelektual,
7. Mervete Hasani.....përfaqësuese nga Shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së.

II

Komisioni i vlerësimit të kërkesave për emërtimin e objekteve publike, është i përkohshëm (deri në zgjedhjet e reja lokale). Mandati i komisionit është: Bën shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, dhe i rekomandon Kuvendit për miratim.

III

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi Anullohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Shtimes për zgjedhjen e komisionit për vlerësimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Shtimes Npi – 01/265 i datës: 28.11.2012.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi